



**British Gymnasium
of Technology**

Gjimnazi Britanik për Teknologji, me qëllim të ofrimit të arsimit dhe edukimit sa më cilësor për të gjithë nxënësit, bazuar në kompetencat e përcaktuara me aktet e brendshme, miraton:

KODIN E MIRËSJELLJES PËR STAFIN E BGT-SË

Neni 1

Qëllimi

Kodi i mirësjelljes ka për qëllim të vendosë rregulla të sjelljes së personelit akademik, administrativ dhe të nxënësve, sipas rregullave të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të institucionit. Kodi synon krijimin e një kulture brenda BGT-së të bazuar në vlera dhe shkallë të lartë etike dhe profesionale, për të avansuar të gjitha proceset në institucion përmes një bahskëveprimi të ngushtë.

Neni 2

Fushëveprimi

Kodi i Mirësjelljes është i detyrueshëm për zbatim në BGT, duke përfshirë personelin akademik, punëtorët e administratës dhe nxënësit dhe të gjithë personat tjerë që në ndonjë formë a tjetër janë të lidhur me BGT-në.

Neni 3

Vlerat

BGT të gjithë punën e bazon në vlerat si:

ndershmëria,

respekti,

morali,

përgjegjësia,

drejtësia,

objektiviteti;

përgjegjshmëria,

korrektësia,

përkushtimi,

solidariteti,

transparenca,

toleranca, dhe,

vlerat tjera të pranuar nga popujt e qytetëruar.

Neni 4

Dinjteti

1. Profesorët, stafi administrativ dhe nxënësit e BGT-së janë të obliguar që të respektojnë integritetin dhe dinjtetin personal dhe profesional të secilit punëtor dhe anëtarë të shkollës.
2. Anëtarët e BGT-së janë të obliguar që të kontribuojnë në krijimin e atmosferës bashkëpunuese, kulturës së tolerancës dhe respektimit të personit të tjetrit.

Neni 5

Parimi i ndalimit të diskriminimit dhe ngacmimit

1. BGT jep mundësi të barabarta çdo personi gjatë procesit të rekrutimit, emërimit, promovimit, pagesave, trajnimeve dhe praktikave të tjera të zbatuara në shkollë pa dallim gjinie, race, origjine etnike, origjine kombëtare, ngjyre, besimi, feje, moshe, uniforme të shërbimit apo statusi që ai përfaqëson, me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike apo edhe bindjeve politike.
2. Për të nxitur një ambient respekti për dinjtetin dhe mirëqenien e çdokujt, prej anëtarëve të BGT-së kërkohet angazhim për të krijuar një ambient pune pa asnjë lloj ngacmimi.
3. Ndalohet ngacmimi verbal, joverbal dhe ai seksual ndaj nxënësve dhe çdo anëtar tjetër të personelit të BGT-së në çdo nivel hierarkike.

Neni 5

Të drejtat e mësimeve

1. Mësimeve ka të drejtë:
 - 1.1. T'i respektohet integriteti personal dhe profesional;
 - 1.2. Të kryejë punën në kushte të sigurta për jetën dhe shëndetin e tij.
 - 1.3. Të trajtohet me respekt, me dinjtet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme nga kushdo, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminime.
 - 1.4. T'i sigurohen kushtet e mjaftueshme për mësime efektive.
 - 1.5. Të ketë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, liri profesionale në zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës.
 - 1.6. T'i krijohen mundësitë për zhvillim profesional.

Neni 6

Detyra për mësimeve

1. Mësimeve ka për detyrë:
 - 1.1. Të respektojë Kushtetutën, ligjet e shtetit dhe rregullat e miratuara institucionet përkatëse dhe organet e shkollës.
 - 1.2. Të bazojë sjelljen e tij në parimet e përcaktuara me këtë Kod;
 - 1.3. Të arrijë njohjen e autoritetit të tij nëpërmjet sjelljes, duke respektuar rregullat e shkollës.
 - 1.4. Të trajtojë këdo, në mjediset e Shkollës, me respekt, me dinjtet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë.
 - 1.5. Të japë ndihmesën e tij për mbarëvajtjen e shkollës, të klasës, kabinetit apo zyrës mësimore ku punon.

- 1.6. Të mbajë uniformën, e miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës gjatë qëndrimit në shkollë.
- 1.7. Të respektojë rregullat institucionale dhe normativat ligjore mbi konsumin e duhanit në mjediset publike.
- 1.8. Të mos përdorë bazën materiale të shkollës për punë personale.
- 1.9. Mësimdhënësit dhe të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë në asnjë mënyrë dhe për asnjë arsye në dokumente zyrtare të cilat nuk janë kompetencë e tyre.

Neni 7

Të drejtat e nxënësve

1. Të drejtat e nxënësve janë:
 - 1.1. E drejta për shkollim sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve të shtetit dhe rregullave të përcaktuara nga Shkolla.
 - 1.2. E drejta për shkollim të drejtë pa asnjë formë të diskriminimit të etnik, religjioz, gjinor apo të statusit social dhe ekonomik. BGT nxjerrë rregullore të vecantë për trajtimin e barabartë të nxënësve me statuse të vecanta.
 - 1.3. E drejta të shfrytëzojë të gjitha format dhe mjetet mësimore të cilat posedon shkolla të dedikuara për mësimnxënie sipas programit edukativo arsimor, klasa, laboratorë dhe hapësirat e tjera të dedikuara për nxënie dhe aktivitete edukative dhe arsimore.
 - 1.4. Të dëgjojë dhe të jetë i dëgjuar.
 - 1.5. Ti shprehë lirshëm mendimet dhe idetë e tij.
 - 1.6. Të jetë i informuar për çështjet që ndërlidhen më të ardhmen arsimore dhe profesionale të tij/saj, për arritshëmërinë dhe çfarë premtojnë kompetencat e përfituara në shkollë.
 - 1.7. E drejta të marrë pjesë në projekte dhe gara të diturisë në nivel shkolle dhe më gjerë.
 - 1.8. E drejta të zgjedh dhe për të qenë i/e zgjedhur në organet që përfaqësojnë nxënësit.
 - 1.9. E drejta e progresit dhe avancimit në bazë të rregullave të parapara nga shkolla në bazë të suksesit dhe talentit të dalluar.

Neni 8

Detyrimet dhe veprimet e ndaluara për nxënësin

1. Nxënësi detyrohet të:
 - 1.1 Të respektojë integritetin e secilit anëtarë të bashkësisë së shkollës.
 - 1.2 Të respektojë kodin e mirësjelljes dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e shkollës.
 - 1.3 Të mbajë uniformën e shkollës gjatë procesit mësimorë dhe praktikës profesionale
 - 1.4 Të respektojë rregullat e ndërmarrjes, e cila ka ofruar praktikën profesionale dhe në harmoni me kontratën që ka shkolla me ndërmarrje
2. Nxënësit të BGT-së i ndalohet:
 - 2.1 Të ofendoj, bulizoj ose sulmoj integritetin personal të çdo anëtari të shkollës në çfarëdo forme qoftë;
 - 2.2 Mbajtja e armëve të ftohta dhe të zjarra si dhe të gjitha mjeteve të tjera që rrezikojnë jetën e të tjerëve,
 - 2.3 Sjelljet dhe veprimet e dhunshme, vandalizmi, fyerja, kërcënimi, konflikti, ndaj nxënësve dhe personelit në institucion dhe jashtë tij,
 - 2.4 Bartja dhe konsumimi i të gjitha llojeve të narkotikëve si drogës, duhanit, pijeve alkoolike e të tjera si në shkollë edhe jashtë saj
 - 2.5 qasja , bartja dhe keqpërdorimi i ditarit të klasës
 - 2.6 falsifikimi i nënshkrimit të prindërve, dokumentacionit të shkollës dhe i çfarëdo dokumentacioni që i dedikohet shkollës
 - 2.7 dëmtimi i inventarit , mjeteve të punës dhe hapësirës shkollore
3. Me rregullore të vecantë për disiplinën në shkollë caktohen masat disiplinore për shkeljet disiplinore.

Neni 9

Plagjiatura

1. Plagjiatura e çdo forme e punimeve dhe ideve rreptësisht e ndaluar në punën intelektuale në BGT.
2. Plagjiatura nënkupton aktin e përvetësimit ose kopjimin e idesë, rezultateve, punimit të shkruar a të ndonjë forme tjetër në tërësi ose edhe pjesërisht, pa e treguar burimin e shfrytëzuar dhe pa pasur asnjë meritë për të njëjtat.
3. BGT harton rregullore të vecantë për ndalimin e plagjiaturës.

Neni 10

Detyrimet në procesin mësimor

Personeli i BGT-së duhet të veprojë në pajtim me rregullat dhe detyrimet që dalin nga procesi mësimor.

Neni 11

Praktikat e ndaluara në procesin mësimor

1. Nxënësit e BGT-së duhet të përmbahen nga kopjimi i çdo forme gjatë kryerjes së obligimeve që dalin në kuadër të procesit mësimor si dhe me rastin kur ata i nënshtrohen vlerësimit të dijes/njohurive.
2. Me kopjim nënkuptohet edhe pranimi ose dhënia e ndihmës, e cila ka ndikim në objektivitetin dhe korrektësinë e vlerësimit të punës së të punësuarve në BGT.

Neni 12

Konflikti i interesit

Është i ndaluar konflikti i interesit për secilin anëtarë të BGT-së qoftë në aspektin ekonomik qoftë në aspektet tjera të tij, sikurse përcaktohet me legjislacion;

Secili anëtarë i BGT-së është i obliguar ta deklaroj konfliktin e interesit nëse shfaqet gjatë kryerjes së një pune;

Mos deklarimi i konfliktit të interesit është shkelje e rend etike.

konflikt i interesit ndodh kur interesi privat i një anëtari të BGT-së, me përjashtim të nxënësve, është në kundërshtim real ose potencial me interesat (jo vetëm ekonomike) e BGT-së. Ky konflikt ka të bëjë edhe me raportet e punës në institucione arsimore apo institucione tjera dhe që konsiderohen si konkurrent potencial.

Neni 13

Zbatimi i Kodit të Mirësjelljes

Të gjithë anëtarët dhe organet ee BGT-së janë përgjegjës për të siguruar zbatimin e rregullave etike të përcaktuara me këtë Kod.

Mosrespektimi i parimeve të këtij kodi dhe shkelja e këtyre parimeve, paraqesin sulm ndaj ndershmërisë dhe detyrave të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve, nxënësve, personelit të administratës dhe të tjerëve të lidhur BGT-në.

Neni 14

Organet për zbatimin e Kodit të Mirësjelljes

1. Organet të cilat zbatojnë Kodin e Mirësjelljes janë:

Komisioni i Etikës;

Komisioni disiplinor për personelin e shkollës;

Komisioni disiplinor për nxënësit.

2. Shkeljet e Kodit të mirësjelljes konsiderohen shkelje të rënda dhe trajtohen vetëm nga ana e Komisionit të Etikës.
3. Shkeljet disiplinore rregullohen me rregullore për disiplinën.

Neni 15

Komisioni i Etikës

1. Komisioni i Etikës është organ profesional i BGT-së ka kompetencë të zgjidhë çështjet e shkeljes së Kodit të Mirësjelljes.
2. Komisioni i Etikës përbëhet nga pesë (5) anëtarë të cilët i emron Drejtori i BGT-së.
3. Anëtarët e Komisionit të Etikës janë: tre (3) mësimdhënës, një (1) përfaqësues i prindërve dhe një (1) përfaqësues i nxënësve.
4. Kryetari i komisionit zgjedhet njëri nga mësimdhënësit në takimin e parë të komisionit.
5. Drejtori i Shkollës kërkon nga ana e Keshillit të prindërve dhe atij të nxënësve të delegojnë anëtarët e tyre në Komision.
6. Mandati i Komisionit është tre (3) vite. Nëse dikujt i përfundon mandati më herët ai/ajo anëtare zëvendësoheyt për pjesën e mbetur të mandatit.
7. Në rast të mospërmbushjes së detyrave nga njëri apo të gjithë anëtarët e Komisionit, Drejtori do të bëj zëvendësimin e tyre pasi ta ketë njoftuar me një raport Këshillin Drejtues të Shkollës.

Neni 16

Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor, është organ profesional i themeluar nga Drejtori i shkollës, i cili është kompetent për zbatimin e procedurave, në rastet kur bëhet shkelje Rregullores për disiplinë nga ana e personelit dhe nxënësve të BGT-së.
2. Komisioni ka mandat 3 vjecar. Nëse dikujt i përfundon mandati më herët ai/ajo anëtare zëvendësoheyt për pjesën e mbetur të mandatit.
3. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë: kryetari dhe dy anëtarë tjerë, një që zgjidhet nga radhët mësimdhënësve dhe një nga personli i BGT-së. Kryetari është nga radhët e mësimdhënësve.
4. Në rast të mospërmbushjes së detyrave nga njëri apo të gjithë anëtarët e Komisionit, Drejtori do të bëj zëvendësimin e tyre pasi ta ketë njoftuar me një raport Këshillin Drejtues të Shkollës.

Neni 17

Komisioni i Ankesave

1. BGT themelon Komsionin e Ankesave si komision i përhershëm me mandat tre vjecar. Nëse dikujt i përfundon mandati më herët ai/ajo anëtarë zëvendësohet për pjesën e mbetur të mandatit.
2. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre anëtarë: kryetari dhe dy anëtarë tjerë, një që zgjidhet nga radhët mësimdhënësve dhe një nga personli i BGT-së. Kryetari është nga radhët e mësimdhënësve.
3. Komisioni i ankesave ka kompetencë të shqyrtoj ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të Etikës dhe Komisionit disiplinor.
4. Në rast të mospërbushjes së detyrave nga njëri apo të gjithë anëtarët e Komisionit, Drejtori do të bëjë zëvendësimin e tyre pasi ta ketë njoftuar me një raport Këshillin Drejtues të Shkollës.

Neni 18

Procedura

1. Shkeljet Etike mund të njoftohen nga të gjithë anëtarët e BGT-së përmes një njoftimi me shkrim.
2. Njoftimit duhet t'i bahskëngjiten të gjitha provat kundrejt personit/personave ndaj të cilëve njoftohet shkelja.
3. Njoftimet anonime nuk pranohen nga ana e Komisionit të Etikës.
4. Në rastet kur njoftimi përmbanë dëshmitar, ata janë të obliguar të paraqiten në Komision.
5. Në momentin që pranon një njoftim, Kryetari i Komisionit thërret një mbledhje për të gjithë natëraët jo më vonë sesa 7 ditë.
6. Shqyrtimi i rastit dhe përgjigja duhet të bëhet brenda 30 ditësh.
7. Komisioni mbanë procesverbal për secilin takim dhe për rastin nxjerrë vendim.
8. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave, ku të paktën dy prej votave pro duhet të jenë nga ana e mësimdhënësve.

Neni 19

Masat

1. Në rastet kur një anëtarë i BGT-së ka kryer akte dhune ose të pamoralshme, ai/ajo suspendohet nga Shkolla deri në zgjidhjen e rastit.
2. Nëse rasti tejkalon Kodin e Mirësjelljes, BGT është e obliguar të njoftoj organet e rendit.
3. Zhvillimi i procedurave tjera ligjore nuk e ndalon Komisionin Etik në zhvillimin e procedurës sipas këtij Kodi.
4. Për shkeljet e Kodit Etik shqiptohet njëra nga këto masa:
 - 4.1. Ulje në pozitë;
 - 4.2. Ulje e pagës/shkurtim i pagës;
 - 4.3. Suspendim i përkohshëm;
 - 4.4. Largim i përhershëm.
5. Komisioni në momentin e shqyrtimit të njëres nga këto masa duhet të arsyetoj në detaje vendimin lidhur me provat në dispozicion.
6. Ndaj vendimit të Komisionit mund të ushtrohet ankesë në afatin prej 15 ditësh.
7. Komisioni është i obliguar që palës t'i dërgoj vendimin me kopjen e të gjitha provave që kanë

quar tek vendimi.

Neni 20

Interpretimi

1. Nëse ka paqartësi në interpretimin e dispozitave të këtij Kodi, Komisioni është i obliguar ta njoftoj Drejtorin e Shkollës.
2. Drejtori i Shkollës me një raport është i obliguar ta njoftoj për këtë Këshillin Drejtues të Shkollës.
3. Këshilli Drejtues themelon një Komision *ad hoc* për interpretimin e Kodit, dhe ai interpretim i shkon Komisionit.
4. Komisioni për interpretim përbëhet nga: një anëtarë nga KD, një mësimdhënës, një anëtarë nga administrata dhe një përfaqësues i prindërve.
5. Interpretimi nuk obligon detyrimisht marrjen e vendimit sipas tij. Komisioni i Etikës është i pavarur në vendimet e tij.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga ana e KD-së.

